

## JU RRËFEJ BARONIN TRAGJIK, NJË MBRET TË MUNDSHËM

Studiuesi dhe albanologu Robert Elsie rrëfen zbulimin e kujtimeve të baronit të famshëm austrohungarez, Franz Baron Nopça. Mënjanimi i albanologut nga Akademia jonë e Shkencave, angazhimi politik dhe kandidimi për kurorën e mbretit të shqiptarëve më 1914, deri tek fundi tragjik, vrasja e dashnorit shqiptar, sekretarit të tij Bajazid Dodës, dhe vetëvrasja më pas.

[E.D.]: *Si lindi interesi juaj për Baron von Nopçën? Si ratë në gjurmë të tij dhe të kujtimeve të tij "Udhëtime në Ballkan"?*

[R.E.]: Albanologjia si lëndë shkencore është tepër interesante sepse ka akoma shumë gjera për të zbuluar. Mbeten shumë dokumente dhe dorëshkrime të pashfrytëzuara nëpër arkivet dhe bibliotekat e Evropës, sepse ka pak shkencëtarë që interesohen, dhe ka akoma më pak shkencëtarë në botën e jashtme që dinë shqip. Prandaj kur dëgjoj për ndonjë dorëshkrim me rëndësi albanologjike, më intereson jashtë mase. Kështu kam mundur të zbuloj, apo themi me modesti të paktën, kam mundur të botoj disa prej këtyre dorëshkrimeve.

Nga biografia e Nopçës, e shkruar nga Gert Robel, *Franz Baron Nopcsa und Albanien: ein Beitrag zu Nopcsas Biographie* (Franc Baron Nopça dhe Shqipëria: një ndihmesë biografisë së Nopçës, Wiesbaden 1966), dija se Nopça kishte vrarë vetën në Vjenë më 1933 dhe që, para vdekjes së tij, e kishte caktuar që dorëshkrimi i kujtimeve të tij ti lihet trashëgim Profesorit Norbert Jokl. Gjatë një udhëtimi në Vjenë, arrita të gjej dhe të siguroj kujtimet në arkivin e Bibliotekës Kombëtare të Austrisë. Ishte për mua një gëzim i madh kur, me në fund, e kisha në dorë dorëshkrimin e kujtimeve të baronit të famshëm, më shumë se 500 faqe të shkruara prej dorës së tij në një gjermanisht të vjetëruar të perandorisë austrohungareze.

[E.D.]: *Personalisht çfarë do të veçonit si më me rëndësi nga pikëpamja albanologjike në lëndën e kujtimeve?*

[R.E.]: Në lidhje me Shqipërinë, Nopça ka qenë i njohur kryesisht si etnolog, por ishte edhe një gjeolog, gjeograf dhe paleontolog me famë. Kujtimet e tij, të cilat mbulojnë periudhën nga 1897 deri më 1917, na prezantojnë Nopçën deri diku edhe si historian i kohës së tij. Para Luftës së Parë Botërore ai kishte blerë një shtëpi në Shkodër ku jetonte, pranë maleve dhe malësorëve të Veriut që i donte aq shumë. Nopça ishte ndër të huajt e parë që kanë depërtuar Malet e Veriut (dhe që i kanë mbijetuar udhëtimit). Ai u shqua gjithashtu si figurë publike dhe politike e kohës së tij. Ai dinte me siguri më shumë për Shqipërinë dhe për shqiptarët e Veriut se çdo austrohungarez tjetër.

[E.D.]: *Më është dukur intrigues fakti që Nopça paskësh qenë komandant i një njësie ushtarake të vullnetarëve shqiptarë si dhe qëndrimi i tij që ju citoni për Kongresin e Triestës në vitin 1913, dhe për zgjedhjen e një princi evropian për Shqipërinë, kur edhe ai paskësh qenë kandidat. Çfarë jepet më shumë nga kujtimet: a ishte Nopça një militant, apo një kandidat nobel për postin e princit?*

[R.E.]: Nuk them se Nopça ishte një militant, por, duke qenë i informuar mirë për Shqipërinë,

ka mundur të mbrojë interesat e saj në Vjenë. Herë ishte i respektuar aty si ekspert, herë ishte i mënjanuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, punë intrigash. Si kandidat për postin e mbretit të Shqipërisë nuk besoj se ai ka qenë i rëndësishëm. Kishte mbështetjen e shqiptarëve të Veriut, por - që është më thelbësore -, nuk kishte mbështetjen e Austrisë, apo të Fuqive të Mëdha. Pas pavarësisë së Shqipërisë, Nopça u tërhoq nga politika, siç thekson, nga inati për faktin se Ismail Qemali, të cilin ai e trajton si tradhtar, i kishte dorëzuar Çamërinë dhe Janinën grekëve. Gjatë Luftës së Parë Botërore ka qenë prapë në Shqipëri, ku organizoi një njësi vullnetarësh shqiptarë nën komandën e Austro-Hungarisë, por, siç dihet, Austro-Hungaria humbi luftën, dhe Nopça u kthye në Vjenë.

[E.D.]: *Si vazhdon më vonë angazhimi i tij politik?*

[R.E.]: Pas Luftës së Parë Botërore ai u tërhoq nga jeta politike fare, dhe jetoi në Vjenë dhe në Budapest, ku për një kohë të caktuar ishte drejtori i Institutit Mbretëror Hungarez të Gjeologjisë (Magyar Királyi Földtani Intézet). Si studiues i pavarur Nopça ishte tepër aktiv gjatë kësaj periudhe dhe botoi me të gjithë 186 punime! 54 të këtyre veprave janë për Shqipërinë dhe për kulturën shqiptare.

[E.D.]: *Duket sikur baroni paska preferuar të jetojë si shqiptar, përderisa paska mbajtur gjatë në shtëpi edhe një sekretar shqiptar. Ka vend për shumë kuriozitet rreth kësaj lloj jete? A ishte një njëri i shkencës që pëlqente të bënte bohemin? Ç'ishte kjo dashuri e baronit për Shqipërinë?*

[R.E.]: Nuk them se Baron Nopça ishte një bohem. Përkundrazi, nga kujtimet e tij ai del si aristokrat konservator dhe një njëri tepër i rreptë dhe i përmbajtur, të paktën në dukje. Për jetën e tij personale flet pak, gjë e kuptueshme për kohën e tij. Për sekretarin dhe dashnorin e tij shqiptar ai thotë: “Më 20 nëntor (1906) jam njohur në Bukuresht me Bajazid Elmaz (Doda). Që prej asaj kohe, Bajazidi ka qenë me mua dhe, pas vdekjes së Lui Drashkoviqit, ai ka qenë i vetmi njeri në botë, të cilën kam dashur vërtetë dhe ndaj të cilit prandaj kam patur një besim të plotë, pa menduar kurrë se ai mund të shfrytëzonte mirëbesimin tim. Ai ka patur edhe huqet e tij, por e kam pranuar siç ishte. Serbët, nga inati për çdo gjë austrohungareze dhe nga inati për mua, duke ditur se unë merrem në mënyrë të veçantë me Shqipërinë, i kanë vrarë babain dhe vëllaun e Bajazidit në Stirovicë më 1913. Në fund të nëntorit, dhejtor dhe në janar 1907 kam qenë me Bajazid në Saçal (vila e baronit në Transilvani) dhe në shkurt kam qenë me atë në Londër...”

Nëse dashuria e tij për sekretarin ka qenë pasoja e dashurisë së tij për Shqipërinë, ose dashuria e tij për Shqipërinë ka qenë pasoja e dashurisë së tij për Bajazidin nuk mund të them, por ka shumë raste të ngjashme të aristokratëve dhe të albanologëve të huaj që kanë patur marrëdhënie intime apo të ngushta më shqiptarë vendas dhe që me siguri u frymëzuan nga këto lidhje. Baronessa gjermane Mari Ameli fon Godin (Marie Amelie von Godin, 1882-1950), e cila kishte shkruar romane aventureske për Shqipërinë dhe kishte përkthyer Kanunin gjermanisht, ishte mike intime afatgjate e aristokratit shqiptar Ekrem bej Vlora (1885-1964). Ata nuk kanë mundur të martoheshin vetëm sepse ajo ishte katolike, kurse ai mysliman. Obri Herbert (Aubrey Herbert, 1880-1923), diplomati dhe shkrintari aristokrat anglez, i cili, bashkë me Edit Durham-in, kishte themeluar Shoqatën Anglo-Shqiptare në Londër për të mbështetur pavarësinë e Shqipërisë, u frymëzua, si Nopça, nga një dragoman shqiptar, Qazim Kokeli. Margaret Hasluck (Margaret Hasluck, 1885-1948), antropologe skoceze, e cila kishte jetuar 13 vjet në Elbasan, ishte mike e ngushtë dhe, sipas thashethemeve, dashnore e dijetarit elbasanas Lef Nosi (1873-1946). Pa

përmendur rastin e jetës skandaloze të Lord Baironit (Lord Byron, 1788-1824), për të cilën është shkruar shumë.

[E.D.]: *Cili është sipas jush vendi i Nopçës në hierarkinë albanologjike?*

[R.E.]: Besoj se në fushën e etnologjisë, pra në fushën e kulturës popullore shqiptare, Nopça zë një vend me shumë rëndësi dhe është për të ardhur keq se veprat e tij nuk janë botuar shqip.

[E.D.]: *A ishte Shqipëria, një arsye e miqësisë së tij më të ngushtë me Norbert Jokl?*

[R.E.]: Në fakt, për miqësinë apo marrëdhëniet midis këtyre dy albanologëve kryesorë të Austrisë, të dy të lindur më 1877, unë di shumë pak. Nopça nuk e përmend Jokl-in në kujtimet e tij, por, siç thashë përpara, ai kishte caktuar që veprat e tij albanologjike të kalojnë Jokl-it pas vdekjes. Ata kanë punuar në fushat e ndryshme: Nopça si etnolog, gjeolog, paleontolog, udhëtar, aventurier, dhe figure publike dhe politike në Vjenë, Shkodër, Sarajevë, Bukuresht dhe Budapesht, kurse Jokl si gjuhëtar, bibliotekar dhe profesor në Universitetin e Vjenës. Me siguri, ka gjëra për të zbuluar këtu. Kjo mund të ishte interesante si temë për një disertacion albanologjik, apo jo?

[E.D.]: *Ju thoni se kryevepra e botimeve albanologjike që dolën jashtë jetës së baronit ishte "Gjeologjia dhe gjeografia e Shqipërisë Veriore". Ku qendron rëndësia e kësaj vepre?*

[R.E.]: *Gjeografia dhe gjeologjia e Shqipërisë Veriore* është vepra më e madhe e Nopçës, kulmi i jetës së tij shkencore. Miku Ludwig Waagen i ka shkruar kështu: "edhe po të mos kishe botuar asnjë vepër tjetër, mund të kënaqesh me këtë kur e rishikon tërë veprën tënde." Megjithatë, ky liber, i cili u botua më 1929 nga Instituti Mbretëror Hungarez i Gjeologjisë me më shumë se 600 faqe, merret "vetëm" me gjeografinë dhe gjeologjinë e Shqipërisë, dhe ndoshta për këtë arsye ka patur më pak jehonë në Albanologji. Ekziston një përkthim i pabotuar shqip nga B. Dashi (Tiranë 1974), por nuk di nëse cilësia e përkthimit mjafton për një botim. Më interesante për publikun shqiptar do të ishin veprat e tij klasike: *Das katholische Nordalbanien* (Shqipëria e Veriut katolike, 56 f.), Vjenë 1907; *Haus und Hausrat im katholischen Nordalbanien* (Shtëpi dhe orëndi në Shqipërinë e Veriut katolike, 92 f.), Sarajevë 1912; *Albanien: Bauten, Trachten und Geräte Nordalbanien* (Shqipëria: ndërtime, veshje dhe vegla popullore e Shqipërisë së Veriut, 257 f.). Berlin 1925, dhe, në radhë të parë, kujtimet e tij të sipërmendura: *Reisen in den Balkan: die Lebenserinnerungen des Franz Baron Nopcsa* (Udhëtime në Ballkan: Kujtimet e Franc Baron Nopçës, 527 f.), Pejë 2001.

[E.D.]: *Mendoni se Akademia e Shkencave e Shqipërisë ka lënë jashtë vëmendjes së duhur një albanolog si Nopça dhe çfarë duhet bërë për botimin e veprës së tij më të rëndësishme albanologjike?*

[R.E.]: Nopça është lënë mënjanë nga albanologjia shqiptare, para së gjithash sepse kjo shkencë përqëndrohet në radhë të parë në studime gjuhësore, historike dhe letrare. Nopça ishte kryesisht etnolog dhe gjeolog, kështu që është njohur më pak. Besoj se ka edhe një arsye tjetër fare e thjeshtë: mungojnë përkthime të veprave të tij shqip. Një traditë e fortë e përkthimit të veprave

shkencore nga gjermanishtja nuk ekziston, dhe për fat të keq, edhe sot nuk ka shumë përkthyes gjermanisht-shqip. Megjithatë, nëse ndonjë botues ishte i interesuar për të botuar kujtimet e Nopçës shqip, apo të paktën atë pjesë të kujtimeve të tij që merren me Shqipërinë, me kënaqësi do të isha gati të japë dorëshkrimin në dispozicion për përkthim dhe botim.

Intervistoi: Elsa Demo

[Botuar në *Shekulli*, Tiranë, 26 dhjetor 2003, f. 19. Published in the Albanian newspaper *Shekulli*, Tirana, 26 December 2003, p. 19]